



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 654/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 10.10.2019, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e shoqërisë “Ndregjoni” sh.p.k., në procedurën e prokurimit me Nr.REF-23330-05-22-2019, me objekt: “*Kanali Strembec*”, me fond limit 18 915 724 lekë pa tvsh, zhvilluar ne daten 24.06.2019 nga autoriteti kontraktor Bashkia Përmet.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e BOE “Agbes Construction” sh.p.k & “2AF” sh.p.k.

Ankimues: BOE “Agbes Construction” sh.p.k & “2AF” sh.p.k
Çorovodë

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Përmet.
Sheshi “Abdyl Frasheri”, Përmet

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Nuk ka respektuar shkallët e ankimimit lidhur me skualifikimin e ofertës së tij.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 23.05.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit me Nr.REF-23330-05-22-2019, me objekt: “*Kanali Strembec*”, me fond limit 18 915 724 lekë pa tvsh, zhvilluar ne daten 24.06.2019 nga autoriteti kontraktor Bashkia Përmet.

II.2. Në datën 09.08.2019 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar si më poshtë:

- | | |
|--|------------------------------|
| 1. “Ndregjoni” sh.p.k | 16.453.290 lekë, kualifikuar |
| 2. BOE “Agbes Construction” sh.p.k & “2AF” sh.p.k. | 18.863.507 lekë, kualifikuar |

II.3. Në datën 14.08.2019, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, nëpërmjet të cilës kundërshton kualifikimin e shoqërisë “Ndregjoni” sh.p.k në procedurën e prokurimit. Konkretisht pretendohet si vijon:

“Ne daten 09.08.2019, ne faqen zyrtare te Agjencise se Prokurimeve Publike, jemi informuar mbi klasifikimin perfundimtar, transmetuar ne rruge elektronike nga Komisioni i Vleresimit te Ofertave per proceduren e prokurimit publik me objekt: "Kanali Strembec", me fond limit: 18

915 724 leke, pa TVSH, zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Bashkia Penmet, ne date 24.06.2019, me renditjen si me poshte vijon:

Nr.	Operatori Ekonomik	Oferta e paraqitur	Pranuar / refuzuar
1	Ndregjoni shpk	16.453.290 leke	pranuar
2	2AF shpk	18.863.507 leke	pranuar

2. Nga permbajtja e informacionit te mesiperem, jemi njoftuar mbi kualifikimin e Operatorit ekonomik Ndregjoni shpk. Nga te dhenat qe disponohen nga ana jone konstatojme qe ky operator ekonomik nuk ploteson kriteret e dhena ne dokumentet e tenderit, prandaj duhet te ishte skualifikuar nga kjo procedure prokurimi. Ne vijim, do argumentojme pikerisht kriteret qe nuk ploteson ky operator ekonomik.

Neni 53 pika 3, e ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" parashikon se autoriteti kontraktor, ne zbatim te pikes 4 te ketij neni, vlereson nje oferte te vlefshme, vetem nese ajo eshte ne perputhje me te gjitha kriteret dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit, pa rene ndesh me percaktimet e nenit 54 te ketij ligji..

2.1. Operatori ekonomik Ndregjoni shpk nuk ka arritur te paraqese dokumentacion te plote dhe te sakte per te deshmuar plotesimin e pikes 2.2/c te kriterëve te vecanta per kualifikim (për pagesen e taksave vendore per cdo vend zhvillimi aktiviteti). Ne kete pike eshte kerkuar; Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje deklarate me shkrim nga administratori se subjekti ka paguar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet per periudhen viti 2017, viti 2018 si dhe kestet perkatese te vitit 2019 qe duhen paguar deri ne daten 20 prill 2019, sipas afateve te percaktuara ne ligjin 9632/2006". Per sistemin e taksave vendore", i ndryshuar neni 14. Kesaj deklarate duhet ti bashkengjiten te gjithë vertetimet qe deshmojne se operatori ekonomik ka paguar detyrimet perkatese, ne vendet ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet per kete periudhe. Nga dokumentacioni ekstrakti i QKB rezulton se, operatori Ndregjoni shpk, ushtron aktivitet edhe ne Farke; Farke e Vogel; Rruga Daxhit, Zona Kadastrale Nr. 1605, numri i pasurise 210/10 dhe 210/11, Tirane. Sipas Numri i ceshtjes: CN-145098-03-19 Arsyet e hapjes se ceshtjes: Depozitimi i vendimit te asamblese se ortakeve Nr. 2 date 27.03.2019 per miratimin e hapjes se nje adrese dytesore. Per kete adrese nuk ka paraqitur vertetim per pagesen e taksave sipas ligjit te sipercituar.

2.2. Ne piken 2.3.2 te kriterëve te vecanta per kualifikim eshte kerkuar; Kandidati/Ofertuesi duhet te dorezoje: 2.3/2 Licence te vlefshme te shoqerise, per zbatim te punimeve (konform VKM-se nr. 42, date 16.01.2008, e ndryshuar) me kategorite e meposhtme. [...] Shqyrtimi dhe vleresimi i licencave duhet te behet mbi bazen e rregullave te parashikuara ne VKM-ne e siperpermendur. Per te deshmuar plotesimin e ketij kriteri, Operatori Ndregjoni shpk ka paraqitur licensen perkatese ku drejtues ligjor eshte vetem z.Xh Ndregjoni. "

Sipas ekstraktit te QKB-se drejtues ligjor qe nga data 20.03.2019 edhe z. B Alstafa. Pra verehet se ka mosperputhje te drejtuesit ligjor te pasqyruar ne license me drejtuesin ligjor sipas ekstraktit te QKB. Ne kreun III "Kategorizirni dhe klasifikimi i licences, elementet e saj, kushtet, kriteret dhe kufizimet", pika 2 dhe pika 3 germa "a", paragrafi 2 te VKM Nr.42, date 16.1.2008 "parashikohet se: 2. Elementet e licences: a) Licenca permбан keto elemente: I. Kategorite e punimeve te ndertimit (percaktuar ne lidhjen nr.2); II. Klasifikimin

me nivele per cdo kategori (percaktuar ne lidhjen nr.4); III.Numrin e identifikimit; IV.Daten e regjistrimit ne Regjistrin Themeltar (e njejte me daten e marrjes se vendimit nga komisioni); V. Emrat e drejtuesve ligjore e teknike; VI. Seline; VII. Afatin e vlefshmerise;VIII.Elementet e sigurise te percaktuara me urdher te ministrit; IX. Te dhenat e plota te kategorive dhe klasifikimit, ne pjesen e pasme te licences (Lidhjet 2 e 4 te kesaj rregulloreje)." [...] Ne kreun I "Qellimi, fusha e veprimit te rregullores dhe perkufizime" pika 2 te VKM Nr.42, date 16.1.2008 parashikohet se: "Drejtues ligjor"-person fizik apo personat fizike (administrator per sh.p.k., drejtor, presidenti per sh.a., personi fizik) te percaktuar si te tille nga vendimi i regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit/ ose ne gjykate Kreu II, pika 5, ku thuhet "Brenda 30 diteve, cdo subjekt i licencuar ne zbatim ka detyrimin te depozitoje aplikimin per perditesimin e te dhenave qe nuk sjellin ndryshim ne klasifikim ... I. Ndryshim apo shtese te drejtuesit/ve ligjor te shoqerise; dhe ne vijim kreu VII percakton se "Shoqeria kryen veprimtari pa drejtues teknik ose shkel afatet e njoftimit te caktuara ne kete rregullore. Ne kete rast komisioni heq licencen per shoqerine/drejtuesit per nje periudhe 3 vjet.

Licenca e paraqitur nga ky subjekt megjithese eshte leshuar nga institucioni pergjegjes, shfaq te meta dhe nuk permbush te gjithe detyrimet ligjore te parashikuara nga akti normativ ne zbatim te ligjit, VKM Nr.42, date 16.1.2008 "Per miratimin e Rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi", Kjo sepse z. Bledar Alstafa eshte emeruar administrator me date 20.03.2019 Referuar dhe ne zbatim te detyrimeve te mesiperme ligjore, OE duhej qe brenda dates 19.04.2019 (brenda 30 diteve) te pasqyronte ndryshimet perkatese ne licensen e shoqerise. Por, megjithese ka kaluar afati ligjor per te pasqyruar ndryshimet ne drejtuesjt ligjore, ai nuk ka here ndryshimin e kerkuar nga baza ligjore ne fuqi. Perputhja e drejtuesve ligjore sipas QKB-se dhe licenses se shoqerise nuk kushtezohet e nuk lidhet me kompetencat qe sipas statutit i eshte caktuar njerit apo tjetrit administrator. VKM dhe ligji 9901/2008 "per shoqerite tregetare" e percakton qarte se, secili administrator, pavaresisht kompetencave eshte drejtues ligjor dhe si i tille duhet te jete medoemos edhe ne licensen e shoqerise. Referuar pikes 5 gemes (a) dhe (b) te Kreut II te VKM nr 42, date 16.01.2008 "Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi", eshte detyrim ligjor i cdo subjekt te licencuar ne zbatim qe te aplikojte per perditesimin e te dhenave.

Ne rregullat e prokurimit percaktohet se, operatoret ekonomike jane te detyruar te pergatisin Oferta, ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne legjislacionin ne fuqi si edhe kriteret e kualifikimit te vendosur nga autoriteti kontraktor. Shqyrtimi dhe vleresimi i licensave do te behet mbi bazen e rregullave te parashikuara ne sa me siper (pra VKM nr 42 date 16.1.2008) Per sa mesiper dokumentacioni i paraqitur nga ky subjekt, ne kete procedure prokurimi, nuk ploteson kerkesat e legjislacionit ne fuqi dhe nuk mund konsiderohet i vlefshem.

2.3. VKM-ja nr 42, date 16.01.2008 "Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi", ne kreu IV, "Drejtuesi teknik i shoqerise dhe papajtueshmeria me kete detyre" pika 2, percakton: Drejtuesit teknike te

shoqerise nuk mund te jene personat qe jane te angazhuar ne cdo punemarrje tjeter publike. Drejtuesi teknik i shoqerise nuk mund te jete njekohesisht i punesuar ne dy apo me shume shoqeri ndertimi dhe ndalohet te disponojne licence per mbikeqyrje e kolaudim te punimeve te zbatimit. Kur personat qe pranojne te kryejne detyren e drejtuesit teknik te shoqerise per zbatim disponojne licence profesionale mbikeqyrjeje e kolaudim punimesh zbatimi, ata kane detyrimin per evidentimin e ketij fakti ne dokumentacionin e paraqitur per aplikim, si dhe dorezimin e kopjes origjinale te ketyre licencave prane arkives se sektorit pergjegjes per licencimin, perpara ose ne castin kur shoqeria ne fjale merr licencen.

Nga informacionet qe disponohen nga ana jone rezulton qe te pakten njeri prej tyre, z. Shaban L, rezulton i punesuar te pakten dhe ne 10 subjekte te tjera, si: Cani shpk, Yldon shpk, Zguri shpk, Besa shpk, Ndreu shpk, Albta shpk etj. Kjo shkelje e ben licencen e OE Ndrejgioni shpk te pavlefshme,

2.4. Ne piken 2.3.6 te Kriteve per kualifikim eshte kerkuar: 2.3.6 Operatori ekonomik duhet te disponoje mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike per realizimin e kontrates. Per kete duhet te paraqese deshmi per mjetet dhe paisjet teknike qe ka ne dispozicion apo mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik. Kerkohen te jene ne dispozicion keto makineri, Pajisje e mjete pune: [...] 5(Fadrome me goma; Cope 1; Ne pronesi ose me qera; 6. Mini-fadrom; Cope 1, Ne pronesi ose me qera. [...].

Per mjetet qe shenohen ne regjistra publike, kur jane ne pronesi, duhet te paraqitet dokumentacioni qe vertetojne pronesine e mjetit: - certifikaten e pronesise; -leja e qarkullimit; -certifikaten e kontrollit teknik; siguracionin; leja e transportit qe leshohet nga njesia vendore dhe fotot perkatese; ndersa per mjete te marra me qera krahas dokumentacionit te mesiperem, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerese e cila duhet te perfshije objektin perkates dhe duhet te jete e vlefshme per te gjithe periudhen deri ne perfundimin e plate te punimeve.

Kapacitetet teknike Fadrome me goma dhe Minifadrom, megjithese jane mjetet qe shenohen ne regjistra publike, per to, ne kundersiztim me kriterin e dhene ne dokumentet e tenderit, nuk eshte paraqitur certifikata e pronesise. KVO-ja ne cdo rast duhet qe te beje vleresimin ne baze te kriteve te hartuara ne dokumentat e tenderit. Kriteret per kualifikim vendosen qe t'i sherbejne autoritetit kontraktor per te krijuar nje panorame te pergjithshme te kapaciteteve dhe mundesise se operatorit per permbushje me sukses te kontrates. Ne varesi te kontrates dhe volumit te saj autoriteti kontraktor percakton kerkesat e vecanta per kualifikim, te cilat jane te detyrueshme per t'u permbushur nga operatoret ekonomike pjesemarres ne procedurat e prokurimit. Operatoret ekonomike jane te detyruar te pergatisin ofertat, ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne dokumentat e tenderit dhe ofertat qe nuk pergatitenne perputhje me keto dokumenta duhet te refuzohen si te papranueshme ne mbeshtetje edhe te pikes 3, te nenit 66 te VKM nr. 914, date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar, ne te cilen percaktohet se komisioni verifikon dhe vlereson ofertat e dorezuara, duke kualifikuar vetem ato oferta, qe permbushin kriteret per kualifikim, te percaktuara ne dokumentat e tenderit. [...]."

ekstrakti, 14. Ortaktet, percaktohet si Administrator Xh. Ndregjoni me pjesemarrje ne perqindje me 100 % (njqind perqind).

- Administratori Xh. Ndregjoni sipas Ekstraktit te QKB, faqe 14, pasqyra ne fund te kesaj faqe, rezulton se ka kohezgjatjen deri ne daten 19/7/2021, me 100% te aksioneve ne pjesemarrje, eshte kjo arsyeja qe ne Ekstrakt Gjendja e Rregjistrimit percaktohet perfaqesuesi qe zoteron kuoten si perfaqesues, ne rastin konkret Xh. Ndregjoni me 100% te pjesemarrjes . Sipas Kuadrit ligjor perkates, Perfaqesuesit, plotesohen ne kete dokument vetem nese zoterojne kuoten si perfaqesues. Per pretendimin qe parashtron ankimuesi se shoqeria ka dhe nje administrator tjeter dhe konkretisht Z. B. Alsafa, i shtuar nga data 19/3/2019 deri 19/3/2024, ne dokumentin e QKB nuk percaktohet se zoteron perqindje ne pjesemarrje, zoterimin me 100% e zoteron vetem administratori Xh. Ndregjoni.

Ne keto kushte KSHA, vlereson se pretendimi i ankimuesit per piken 2,2, parashtruar ne formularin e ankeses, nuk qendron dhe nuk duhet te merret parasysh .

2.3. Sipas pikes 2.3 te Formularit te ankeses te "2AF" shpk, pretendohet se Ofertuesi i kualifikuar nga KVO, konkretisht "Ndregjoni shpk, sipas ankimuesit, rezulton qe te pakten njeri prej tyre z. Shaban L. (behet fjale per drejtues teknik te shoqerise "Ndregjoni" shpk) rezulton i punesuar te pakten dhe ne 10 subjekte te tjera Per kete pretendim ankimuesi i referohet VKM nr. 42 ,date 16/01/2008 "Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi", ne kreun IV, Drejtuesit teknike shoqerise dhe papajtueshmeria me kete detyre, pika 2, percakton: Drejtuesit teknike te shoqerise nuk mund te jene personat qe jane te angazhuar ne cdo punemarrje tjeter publike. Drejtuesit teknike i shoqerise nuk mund te jene njekohesisht i punesuar ne dy apo me shume shoqeri ndertimi dhe ndalohet te disponoje licence per mbikqyrje e kolaudim te punimeve te zbatimit. KSHA, ne vleresim te ketij pretendimi te ankimuesit u njoh me dokumentacionin zyrtar qe disponon A.K Bashkia Permet, ku per vleresimin e ofertave nga ana e KVO-se eshte kerkuar Institucioneve perkatese, informacion para se te perfundonte procedura e vleresimit te ofertave ne SPE, nga ku rezultoi se asnje drejtues teknik i shoqerise "Ndregjoni" shpk, nuk eshte ne kushtet e shkeljes se VKM nr 42 date 16/01/2018, persa i perket punesimit te tyre ne instiucione publike apo ne rolin e drejtuesve teknike ne shoqeri te tjera ndertimi, apo qe te disponojne licenca profesionale per mbikqyrje e kolaudim punimesh. Ky informacion aktualisht eshte lehtesisht i aksesueshem ne faqet zyrtare te insitucioneve pergjegjese per dhenien e ketyre licencave. Theksojme gjithashtu se pervec papajtueshmerise me detyren e drejtuesit teknik ne nje shoqeri ndertimi, sipas VKM nr. 42, date 16/01/2008, cdo profesionist jashte kohes zyrtare te punes, sipas kontates perkatese me shoqerine ne rolin e drejtuesit teknik, nuk ndalohet nga ligji per pune private, ne kompani te tjera, duke perfituar dhe sigurime shoqerore shtese nga pjesemarrja ne keto kompani. Kjo punemarrje me kohe jo te plote, jashte kohes se punes si drejtues teknik i shoqerise eshte sqaruar perfundimisht nga kuadri ligjor e nenligjor perkates ne fuqi. Per kete, si reference, ka nje sere vendimesh te KPP, per raste ne ngjashme me pretendimin e ankimuesit.

Persa siper KSHA, vlereson se pretendimi i ankimuesit "2AF" shpk per drejtuesin teknik te shoqerise "Ndregjoni" shpk, z, Shaban L. nuk qendron dhe nuk duhet te merret parasysh.

2.4. Sipas pikes 2.4. te Formularit te ankeses te "2AF" shpk, ankimuesi pretendon se Shoqeria "Ndregjoni" shpk, nuk ka paraqitur certifikaten e pronesise per mjetin fadrome me goma dhe minifadrome, ne kundershtrim me kriterin e dhene ne dokumentat e tenderit.

Ne vleresim te ketij pretendimi, KSHA u njoh nepermjet KVO-se ne sistem me dokumentacionin per mjetet dhe paisjet teknike qe disponon dhe ka vene ne dispozicion Ofertuesi "Ndergjani" shpk, per realizimin e kontrates se njoftuar nga A.K. Bashkia Permet per proceduren e prokurimit me objkt "Kanali Strembec" nga ku konstatoi:

Ne plotesim te kerkeses se A.K pika 2.3.6 per disponimin e mjeteve nga ofertuesit rezulton se O.E. "Ndregjoni", me dokumentacionin e ngarkuar ne sistem per proceduren e prokurimit te njoftuar nga A.K. Bashkia Permet, i ploteson te gjitha kerkesat per mjetet dhe paisjet e nevojshme per te realizuar kontraten e publikuar te kesaj procedure prokurimi.

Ne keto kushte KSHA vlereson se pretendimi i ankimuesit "2AF" shpk parashtuar ne piken 2.4 te formularit te ankeses nuk qendron dhe nuk duhet te merret parasysh.

Ne vleresim te pergjithshem te gjithe pretendimeve te parashtuara nga ankimuesi "2AF" shpk ne ankesen e tij, drejtuar A.K Bashkia Permet, ku kerkohet skualifikimi i ofertes te O.E. "Ndregjoni" shpk, oferte e cila eshte kualifikuar dhe eshte renditur ne vend te pare nga ana e KVO-se, si oferte fituese, pas shqyrtimit te proces verbalit te hartuar nga Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, i ngritur me urdherin e Titullarit te A.K. nr.244 date 15/08/2019, ju shprehim si me poshte:

1- Vleresimi i bere nga ana e KVO-se,te A.K. bashkia Permet, oferten e O.E."Ndregjoni" shpk, eshte ne perputhje te plote me kerkesat e AK ne Njoftimin e Kontrates, DT te kesaj procedure prokurimi, si nje oferte e vlefeshme qe i permbush te gjitha kerkesat per zbatimin e kontrates.

2- Nuk merren parasysh pretendimet e ngritura nga ana juaj drejtuar A.K.per ofertuesin "Ndregjoni"shpk, duke e konsideruar vleresimin e bere nga ana e KVO-se ne perputhje te plote me LPP dhe RRPP.

II.5. Në datën 26.08.2019 autoriteti kontraktor ka bërë rivlerësimin e procedurës së prokurimit në SPE si vijon:

- | | |
|--|-------------------------------|
| 1. "Ndregjoni" sh.p.k | 16.453.290 lekë, kualifikuar |
| 2. BOE "Agbes Construction" sh.p.k & "2AF" sh.p.k. | 18.863.507 lekë, skualifikuar |

BOE "Agbes Construction" sh.p.k & "2AF" sh.p.k ka marrë dijëni për skualifikimin e tij me argumentat e mëposhtme:

"Ne daten 15.08.2019 autoriteti kontraktor Bashkia Permet ka ngritur komisionin e shqyrtimit te ankeses me nr.244 date 15.08.2019 me nr.2095 prot per shqyrtimin e ankeses se operatorit ekonomik "Ndregjoni"shpk ku kerkon skualifikimin e Bashkimit te operatoreve ekonomik "Agbes Konstruksion" dhe 2AF shpk.Komisioni merr në shqyrtim ankesën në mbështetje të pikave 3 dhe 5 të nenit 63 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 " Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar) dhe VKM nr.914 dt. 29.12.2014" Për miratimin e rregullave për prokurimin publik " (të ndryshuar) dhe pasi administruam dosjen e tenderit konkretisht dokumentat standarte të tenderit , projektin ,

preventivin si dhe proces-verbalin e komisionit të vlerësimit të ofertave mbi shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave konkluduar sa më poshtë vijon:

1. Është kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në dokumentat standarte të tenderit "Kriteret e veçanta për kualifikim pika

2.3.1, përvija të suksesshme të realizuara si më poshtë:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën

a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë sa 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit dhe konkretisht: 9 457 862 (nente milion e katerqind e pesedhjetë e shtate mijë e teteqind e gjashtedhjetë e dy) lekë pa TVSH.

b. punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është në një vlerë sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 37 831 448 (tridhjetë e shtate milion e teteqind e tridhjetë e një mijë e katerqind e dyzete e tete) lekë pa TVSH.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve të sipërpervendura e ben oferten të kualifikueshme.

2.3.1/a Për kontrata të realizuara me autoritete publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formularin e vlerësimit

2. Kontratë

3. Situacionin përfundimtar;

4. Aktin e kolaudimit;

5. Çertifikaten e marrjes në dorezim.

6. Faturat tatimore perkatëse për çdo situacion

2.3.1/b Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formularin e vlerësimit

2. Kontrate;

3. Lejen e ndertimit

4. Situacionin përfundimtar;

5. Akt kolaudimi objekti;

6. Çertifikaten e marrjes në dorezim të objektit;

7. Fatura tatimore për çdo situacion punimesh.

Pika 2.3/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Operatori ekonomik "Ndregjoni" shpk pretendon në piken e pare të ankeses së bashkimi i operatoreve ekonomik "AGBES KONSTRUKSION" dhe "2AF" nuk përmbushin piken 2.3.1 për realizimin e punëve të ngjashme.

Komisioni i shqyrtimit të ankesës pasi ben verifikimin e dokumentave nga sistemi elektronik venen se në baze të kontratës për bashkim të perkoheshem të operatoreve ekonomik me nr.1084 Rep, nr.424 Kol, date 21.06.2019 operatori ekonomik AGBES KONSTRUKSION shpk merr persiper të

kryej 86 % te punimeve kurse operatori ekonomik 2AF merr persiper te kryej 14 % te punimeve sipas zerave te preventivit.

Per te permbushur kete kriter operatori ekonomik AGBES CONSTRUKSION ka paraqitur kontraten me nr 8400/4 date 30.12.2014 me objekt "Masa inxhinierike ne segmentin rrugor Buzuq-Çorovode" me vlere te kontrate 689 912 080 leke me tvsh si dhe ka paraqitur edhe kontraten shtese me nr.7167/4 date 09.09.2015 me objekt: "Masa inxhinierike ne segmentin rrugor Buzuq-Çorovode" me vlere te kontrates 137 732 767 leke me tvsh. Per keto kontrata ky operator ekonomik ka paraqitur formular vleresimi, situacione perfundimtare, akt kolaudimi si dhe fatura tatimore per cdo situacion punimesh. Edhe pse kemi te bejme me nje kontrate per kryerjen e nje rruge zerat e preventivit te kesaj kontrate jane te ngashme me ato te preventivit te prokurimit me objekt : "Kanali Strembec" dhe si perfundim operatori AGBES CONSTRUKSION e permbush pjese e vet per 86 % te punimeve qe ka marre persiper te kryej.

Kurse operatori ekonomik 2AF per te deshmuar se e permbush piken 2.3.1 per realizimin e kryerjes se puneve te ngjashme ne sektorin publik ose privat ka paraqitur kontraten me objekt : "Skema vaditese Ballaban" te lidhur me autoritetin kontraktor Bashkia Kelcyre ku ka qen bashkim operatoresh me operatorin ekonomik "SHENDELLI" shpk. Vlere e kontrates ka qen 24 956 068,24 leke me TVSH. Operatori ekonomik SHENDELLI per kete kontrate ka marr persiper te kryej 88 % te punimeve kurse operatori ekonomik 2AF ka marr persiper te kryej 12% te punimeve ne baze te kontrates per bashkim te perkoheshem te operatoreve ekonomik dhe ne baze te formularit te vleresimit.

Operatori ekonomik 2AF ne baze te kesaj kontrate deshmon te kete kryer: 2 495 606.82399 lek pa TVSH pune te ngjashme.

$24\,956\,068.24 / 1.2 = 20\,796\,723.5333$ leke pa TVSH.

$20\,796\,723.5333 \times 12\% = 2\,495\,606.7999$ leke pa TVSH.

Operatori ekonomik per kontratem me objekt "Kanali Strembec" ka mare persiper te kryej 14% te punimeve sipas preventivit. Per te permbushur kriterin e puneve te ngjashme ky operator duhet te kete kryer pune sa 50% e fondit limit ose sa dyfishi i fondit limit gjate tre viteve te fundit ne perputhje me perqindjen e mare persiper ne baze te kontrates per bashkim te perkoheshem te operatoreve ekonomik.

$9\,457\,862 \times 14\% = 1\,324\,100$ leke pa TVSH.

Si perfundim edhe operatori ekonomik 2AF e permbush kriterin e puneve te ngjashme ne perputhje me perqindjen e mare persiper ne bashkimin e perkoheshem te operatoreve ekonomik ne mbeshtetje te VKM nr.914 date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" neni 74 Bashkimi i operatoreve ekonomik.

Sa me siper pretendimi i operatorit ekonomik "Ndregjoni" shpk per kete pike nuk qendron.

2. Ne ankesen e tij operatori ekonomik "Ndregjoni" shpk pretendon se bashkimi i operatoreve ekonomik nuk permbush piken 2.3.4 Operatori duhet te deshmoje se ka pjese te stafit teknik qe do te angazhohet per realizimin e punimeve stafin e meposhtem;

a. Stafit Teknik i Shoqerisë të ketë në përbërje :

1) Inxhinier Hidroteknik 1 (një)

2) Inxhinier Topograf 1 (një)

Secili prej pjestarëve të stafit teknik të mësipërm, duhet jetë në Listëpagesat dhe në licencën e shoqërisë. Për secilin prej pjesëtarëve të stafit duhet të paraqitet kontratë pune e vlefshme dhe diploma.

Komisioni i shqyrtimit të ankesës nga verifikimet e kryera në sistemin verifikues se ky bashkim operatorësh për të përmbushur këto kriter ka dorëzuar dokumentacionin e mëposhtem:

1- Licencën profesionale të shoqërisë

2- Ka dorëzuar kontratën individuale të punës midis punëdhënësit "AGBES KONSTRUKSION" shpk dhe punëmaresit Agim Abazi i cili është i punësuar në detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë profili ing. ndertimi. Për ing. ndertimit është dorëzuar diploma, librezë e punës si dhe inxhinieri i mesipërm figuron në listëpagesat dhe në licencën e shoqërisë.

3- Ka dorëzuar kontratën individuale të punës midis punëdhënësit "AGBES KONSTRUKSION" shpk dhe punëmaresit Kostandin Prendit i cili është i punësuar në detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë profili ing. gjeodet. Për ing. gjeodet është dorëzuar diploma, librezë e punës si dhe inxhinieri i mesipërm figuron në listëpagesat dhe në licencën e shoqërisë. Komisioni i shqyrtimit të ankesave konstaton se dokumentacioni i bashkimit të operatorëve ekonomik nuk është në përputhje me kriteret e hartuara nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Permet, pasi ky bashkim operatorësh nuk deshmohet të ketë të punësuar në detyrën e drejtuesit teknik një ing. hidroteknik. Autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit me të drejtë ka kërkuar që operatorët ofertues të kenë të punësuar një ing. hidroteknik duke u nisur edhe nga natyra e prokurimit ku kemi të bëjmë me një kanal vadites dhe prania e këtij punonjësi është e rëndësishme në ndjekjen e punimeve.

Në nenin 46, pika 1 gërma "b" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.

b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;

Në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, neni 26, pika 8, përcaktohet se:

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose;

b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose;

c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën."

Pretendimi i palës ankimese "Ndregjoni shpk se dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik "AGBES KONSTRUKSION" shpk dhe "2AF" për drejtuesin teknik hidroteknik nuk është i rregullt, qendron.

3. Është kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në dokumentat standarte të tenderit "Kriteret e veçanta për kualifikim pika 2.3.6 Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontrates. Për këto duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe paisjet teknike që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik.

Kerkohen të jenë në dispozicion këto makineri, pajisje e mjete pune;

Nr Emri i mjetit Njesi Sasi Statusi

1 Kamiona vetshkarkues Copë 1 Në pronësi ose me qera

2 Kamioncine deri 3.5 ton Copë 1 Në pronësi ose me qera

3 Autobot Uji Copë 1 Në pronësi ose me qera

4 Autobetoniere Copë 1 Në pronësi ose me qera

5 Fadrome me goma Copë 1 Në pronësi ose me qera

6 Mini fadrom Copë 1 Në pronësi ose me qera

7 Eskavator me zinxhir Copë 1 Në pronësi ose me qera

8 Motobetoniere Cope 2 Në pronësi ose me qera

9 Minieskavatore Copë 1 Në pronësi ose me qera

10 Fabrike betoni e pajisur me leje mjedisore Në pronësi ose me qera ose kontrate furnizimi

11 Matrapik Cope 1 Në pronësi ose me qera

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojnë pronësinë e mjetit: - certifikatën e pronësisë; -leja e qarkullimit; - certifikatën e kontrollit teknik; siguracionin ; leja e transportit që leshohet nga njësia vendore dhe fotot perkatese; ndërsa për mjete të marra me qera krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerave e cila duhet të përfshijë objektin perkates dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plote të punimeve.

- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese, ndërsa për mjete të marra me qera krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerave e cila duhet të përfshijë objektin perkates dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plote të punimeve.

Ne ankesën e tij operatori ekonomik "Ndregjoni" shpk pretendon se bashkimi i operatoreve ekonomik "AGBES KONSTRUKSION" shpk dhe "2AF" nuk kanë dorëzuar dokumentacion të rregullt për automjetet dhe konkretisht për automjetin fadrome me goma cope 1 në pronësi ose me qera. Komisioni i shqyrtimit të ankesave nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike verën se në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik "AGBES KONSTRUKSION" sh.p.k, ka dorëzuar SHTOJCEN 10 ku ka deklaruar mjetin fadrome me goma: - Për mjetin fadrome me goma operatori ekonomik "AGBES KONSTRUKSION" shpk ka dorëzuar vetëm faturen e çdoganimit dhe fotot e mjetit.

Komisioni i shqyrtimit të ankesës verën se dokumentacioni i operatorit ekonomik "AGBES KONSTRUKSION" shpk për këto mjet nuk është i rregullt pasi mjeti fadrome me goma është një mjet që është i regjistruar në regjistrin publik dhe si i tillë ky operator për të përmbushur këtë kriter duhet të paraqiste dokumentacionin sic kerkohet në dokumentat e tenderit të cilat janë : - certifikatën e pronësisë; -leja e qarkullimit; -certifikatën e kontrollit teknik; siguracionin ; leja e transportit që leshohet nga njësia vendore dhe fotot perkatese;

Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.

b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

Neni 26, pika 8, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se : Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose 6

c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Pretendimi i palës ankimese se dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatoreve ekonomik “AGBES KONSTRUKSION” shpk dhe “2AF” per automjetet nuk eshte i rregullt qendron.

Referuar shpjegimeve të mësipërme mbi shqyrtimin e ankesës e kryer në përputhje të plotë me dokumentat standarte të tenderit , Ligjit 9643, date 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, Neni 46 , pika 1 , neni 53, pika 3 dhe Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 “Per rregullat e prokurimit publik”, (i ndryshuar), neni 14, Neni 26, neni 74 pika 1, 2, 3 rezulton se bashkimi i operatorëve ekonomikë “AGBES KONSTRUKSION” shpk dhe “2AF” Shpk nuk permbush kriteret e vecanta per kualifikim te përcaktuara ne dokumentat e tenderit.Sa më sipër, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës vendosi që argumentimet dhe pretendimet e paraqitura në ankesë janë mbështetur në aktet ligjore për prokurimin publik.

Ne keto kushte ankesa e paraqitur nga operatori ekonomikë “Ndregjoni” Shpk per skualifikimin e bashkimit te operatoreve ekonomik duhet te pranohet pjeserish vetem per dy nga pretendimet e ngritura kurse pretendimet e tjera jane te pabazuara ne rregullat e prokurimit publik.”

II.6. Në datën 27.08.2019, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke pretenduar si vijon:

“[...] I jemi drejtuar me nje ankese Autoritetit Kontraktor, me date 14.08.2019, ku e kemi vene ne dijeni qe Operatori ekonomik Ndregjoni shpk, rezulton te jete kualifikuar ne kundershtrim me ligjin, dhe si rrjedhim duhet skualifikuar.

Autoritetit Kontraktor, me shkresen nr. 2144, date 20.08.2019, (dorezuar prane subjektit tone me date 22.08.2019), e ka refuzuar ate, duke lene ne fuqi vendimin e Komisionit te Vleresimit te Ofertave.

Nje dite pasi kemi mare pergjigje nga AK, njoftohemi nepermjet sistemit qe oferta jone eshte refuzuar per arsye qe nuk i dime. Bazuar ne parimet baze te nje procesi te rregullt ligjor Ankimuese nuk mund te mari nje mase me te rende nese ankohet nje proces administrativ ose gjyqesore. Po keshtu per sa kohe qe AK nuk na kishte klasifikuar ne vendin e pare ne kete Procedure Prokurimi, bazuar ne LPP asnje ankimues nuk ligjerohet te ngreje pretendime ndaj ofertes tone per sa kohe qe asnje OE nuk eshte demtuar apo rrezikon te demtohet per shkak se nuk kishte asnje operator tjetër te kualifikuar pas ofertes tone. AK ka shkelur teresisht dhe ne menyre te hapur LPP duke u hakmarre per shkak te ankeses tone.

Bazuar ne neni 63 / 6, te ligjit nr. 9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndyshuar, «Nese autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesen brenda afatit kohor te percakuar ne piken 5 te lditij neni, ose e refuzon ate, ankimuesi mund te paraqese nje ankese me shkrim ne Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 diteve nga dita e neserme e punes, pas perfundimit te afatit kohor, te percakuar ne piken 5 te ketij neni, ... », ju drejtohem me kete ankese, duke paraqitur argumente bindese, dhe kerkojme skualifikimin e tij, pasi nuk permbush kriteret e dhena ne dokumentet e tenderit, per kete procedure prokurimi [...]”.

Më pas ankimuesi ka parashtruar në Komisionin e Prokurimit Publik të njëjtat pretendime si edhe në autoritetin kontraktor, përsa i përket ofertës së paraqitur nga shoqëria “Ndrejoni” sh.p.k.

II.7. Në datën 09.09.2019 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1436/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 2296 prot., datë 06.09.2019, bashkëngjitur informacioni e dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e BOE “Agbes Construction” sh.p.k & “2AF” sh.p.k, për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në datën 09.08.2019 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar si më poshtë:

- | | |
|--|------------------------------|
| 1. “Ndregjoni” sh.p.k | 16.453.290 lekë, kualifikuar |
| 2. BOE “Agbes Construction” sh.p.k & “2AF” sh.p.k. | 18.863.507 lekë, kualifikuar |

III.1.2. Në datën 14.08.2019 ankimuesi ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, nëpërmjet të cilës kundërshton kualifikimin e shoqërisë “Ndregjoni” sh.p.k në procedurën e prokurimit.

III.1.3. Nëpërmjet shkresës nr. 2144 prot., datë 20.08.2019 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit duke e refuzuar ankesën.

III.1.4. Në datën 26.08.2019 autoriteti kontraktor ka bërë rivlerësimin e procedurës së prokurimit në SPE si vijon:

- | | |
|--|-------------------------------|
| 1. “Ndregjoni” sh.p.k | 16.453.290 lekë, kualifikuar |
| 2. BOE “Agbes Construction” sh.p.k & “2AF” sh.p.k. | 18.863.507 lekë, skualifikuar |

BOE “Agbes Construction” sh.p.k & “2AF” sh.p.k ka marrë dijëni elektronikisht për arsyet e skualifikimit të tij si vijon:

“Ne datën 15.08.2019 autoriteti kontraktor Bashkia Permet ka ngritur komisionin e shqyrtimit të ankesës me nr.244 datë 15.08.2019 me nr.2095 prot per shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik "Ndregjoni" shpk ku kërkon skualifikimin e Bashkimit të operatoreve ekonomik "Agbes Konstruktion" dhe 2AF shpk. Komisioni merr në shqyrtim ankesën në mbështetje të pikave 3 dhe 5 të nenit 63 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 “ Për Prokurimin Publik ” (i ndryshuar) dhe VKM nr.914 dt. 29.12.2014“ Për miratimin e rregullave për prokurimin publik ” (të ndryshuar) dhe pasi administruam dosjen e tenderit konkretisht dokumentat standarte të tenderit , projektin , preventivin si dhe proces-verbalin e komisionit të vlerësimit të ofertave mbi shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave konkluduar sa më poshtë vijon:

1.Është kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në dokumentat standarte të tenderit "Kriteret e veçanta për kualifikim pika

2.3.1,pervoja të suksesshme të realizuara si më poshtë:

2.3.1 Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën

a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë sa 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit dhe konkretisht: 9 457 862 (nente milion e katerqind e pesedhjetë e shtate mijë e teteqind e gjashtedhjetë e dy) lekë pa TVSH.

b. punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është në një vlerë sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 37 831 448 (tridhjetë e shtate milion e teteqind e tridhjetë e një mijë e katerqind e dyzete e tete) lekë pa TVSH.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve të sipërpermendura e ben oferten të kualifikueshme.

2.3.1/a Për kontrata të realizuara me autoritete publike,operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Formularin e vlerësimit

2. Kontratë

3. Situacionin përfundimtar;

4. Aktin e kolaudimit;

5. Çertifikaten e marrjes në dorezim.

6. Faturat tatimore perkatese per cdo situacion

2.3.1/b Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- 1. Formularin e vleresimit*
- 2. Kontrate;*
- 3. Lejen e ndertimit*
- 4. Situacionin përfundimtar;*
- 5. Akt kolaudimi objekti;*
- 6. Çertifikaten e marrjes ne dorezim te objektit;*
- 7. Fatura tatimore per cdo situacion punimesh.*

Pika 2.3/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Operatori ekonomik “Ndregjoni” shpk pretendon ne piken e pare te ankeses se bashkimi i operatoreve ekonomik“AGBES CONSTRUKSION” dhe“2AF” nuk permbushin piken 2.3.1 per realizimin e puneve te ngjashme.

Komisioni i shqyrtimit te ankeses pasi ben verifikimin e dokumentave nga sistemi elektronik veren se ne baze te kontrates per bashkim te perkoheshem te operatoreve ekonomik me nr.1084 Rep, nr.424 Kol, date 21.06.2019 operatori ekonomik AGBES CONSTRUKSION shpk merr persiper te kryej 86 % te punimeve kurse operatori ekonomik 2AF merr persiper te kryej 14 % te punimeve sipas zerave te preventivit.

Per te permbushur kete kriter operatori ekonomik AGBES CONSTRUKSION ka paraqitur kontraten me nr 8400/4 date 30.12.2014 me objekt “Masa inxhinierike ne segmentin rrugor Buzuq-Çorovode” me vlere te kontrate 689 912 080 leke me tvsh si dhe ka paraqitur edhe kontraten shtese me nr.7167/4 date 09.09.2015 me objekt: “Masa inxhinierike ne segmentin rrugor Buzuq-Çorovode” me vlere te kontrates 137 732 767 leke me tvsh.Per keto kontrata ky operator ekonomik ka paraqitur formular vleresimi,situacione perfundimtare,akt kolaudimi si dhe fatura tatimore per cdo situacion punimesh. Edhe pse kemi te bejme me nje kontrate per kryerjen e nje rruge zerat e preventivit te kesaj kontrate jane te ngjashme me ato te preventivit te prokurimit me objekt : “Kanali Strembec” dhe si perfundim operatori AGBES CONSTRUKSION e permbush pjese e vet per 86 % te punimeve qe ka marre persiper te kryej.

Kurse operatori ekonomik 2AF per te deshmuar se e permbush piken 2.3.1 per realizimin e kryerjes se puneve te ngjashme ne sektorin publik ose privat ka paraqitur kontraten me objekt : “Skema vaditese Ballaban”te lidhur me autoritetin kontraktor Bashkia Kelcyre ku ka qen bashkim operatoresh me operatorin ekonomik “SHENDELLI” shpk.Vlere e kontrates ka qen 24 956 068,24 leke me TVSH.Operatori ekonomik SHENDELLI per kete kontrate ka marr persiper te kryej 88 % te punimeve kurse operatori ekonomik 2AF ka marr persiper te kryej 12% te punimeve ne baze te kontrates per bashkim te perkoheshem te operatoreve ekonomik dhe ne baze te formularit te vleresimit.

Operatori ekonomik 2AF ne baze te kesaj kontrate deshmon te kete kryer:2 495 606.82399 lek pa TVSH pune te ngjashme.

$24\,956\,068.24 / 1.2 = 20\,796\,723.5333$ leke pa TVSH.

$20\,796\,723.5333 \times 12\% = 2\,495\,606.7999$ leke pa TVSH.

Operatori ekonomik per kontratem me objekt "Kanali Strembec" ka mare persiper te kryej 14% te punimeve sipas preventivit. Per te permbushur kriterin e puneve te ngjashme ky operator duhet te kete kryer pune sa 50% e fondit limit ose sa dyfishi i fondit limit gjate tre viteve te fundit ne perputhje me perqindjen e mare persiper ne baze te kontrates per bashkim te perkoheshem te operatoreve ekonomik.

$9\,457\,862 \times 14\% = 1\,324\,100$ leke pa TVSH.

Si perfundim edhe operatori ekonomik 2AF e permbush kriterin e puneve te ngjashme ne perputhje me perqindjen e mare persiper ne bashkimin e perkoheshem te operatoreve ekonomik ne mbeshtetje te VKM nr.914 date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" neni 74 Bashkimi i operatoreve ekonomik.

Sa me siper pretendimi i operatorit ekonomik "Ndregjoni" shpk per kete pike nuk qendron.

2. Ne ankesen e tij operatori ekonomik "Ndregjoni" shpk pretendon se bashkimi i operatoreve ekonomik nuk permbush piken 2.3.4 Operatori duhet te deshmoje se ka pjese te stafit teknik qe do te angazhohet per realizimin e punimeve stafin e meposhtem;

a. Stafi Teknik i Shoqerise te ketë në përbërje :

1) Inxhinier Hidroteknik 1 (një)

2) Inxhinier Topograf 1 (një)

Secili prej pjestarëve të stafit teknik të mësipërm, duhet jetë ne Listëpagesat dhe ne licensen e shoqerise. Per sejcilin prej pjesetareve te stafit duhet te paraqitet kontratë pune e vlefshme dhe diploma.

Komisioni i shqyrtimit te ankeses nga verifikimet e kryera ne sistem veren se ky bashkim operatoresh per te permbushur kete kriter ka dorzuar dokumentacionin e meposhtem:

1- Licencen profesionale te shoqerise

2- Ka dorezuar kontraten individuale te punes midis punedhenesit "AGBES KONSTRUKSION" shpk dhe punemaresit Agim Abazi i cili eshte i punesuar ne detyren e drejtuesit teknik te shoqerise profili ing. ndertimi. Per ing. ndertimit eshte dorezuar diploma, librezë e punes si dhe inxhinieri i mesiperperm figuron ne listpagesat dhe ne licencen e shoqerise.

3- Ka dorzuar kontraten individuale te punes midis punedhenesit "AGBES KONSTRUKSION" shpk dhe punemaresit Kostandin Prendit i cili eshte i punesuar ne detyren e drejtuesit teknik te shoqerise profili ing. gjeodet. Per ing. gjeodet eshte dorezuar diploma, librezë e punes si dhe inxhinieri i mesiperperm figuron ne listpagesat dhe ne licencen e shoqerise. Komisioni i shqyrtimit te ankesave konstaton se dokumentacioni i bashkimit te operatoreve ekonomik nuk eshte ne perputhje me kriteret e hartuara nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Permet, pasi ky bashkim operatoresh nuk deshmon te kete te punesuar ne detyren e drejtuesit teknik nje ing. hidroteknik. Autoriteti kontraktor ne dokumentat e tenderit me te drejte ka kerkuar qe operatoret ofertues te kene te punesuar nje ing. hidroteknik duke u nisur edhe nga natyra e prokurimit ku kemi te bejme me nje kanal vadites dhe prania e ketij punonjesi eshte e rendesishme ne ndjekjen e punimeve.

Në nenin 46, pika 1 gërma "b" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që

autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.

b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;

Në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, neni 26, pika 8, përcaktohet se:

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose;

b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose;

c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën."

Pretendimi i palës ankimese "Ndregjoni'shpk se dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatoreve ekonomik "AGBES KONSTRUKSION" shpk dhe "2AF" për drejtuesin teknik hidroteknik nuk është i rregullt, qendron.

3. Është kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në dokumentat standarte të tenderit "Kriteret e veçanta për kualifikim pika 2.3.6 Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këto duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik.

Kerkohen të jenë në dispozicion këto makineri, pajisje e mjete pune;

Nr Emri i mjetit Njesi Sasi Statusi

1 Kamiona vetshkarkues Copë 1 Në pronësi ose me qera

2 Kamioncine deri 3.5 ton Copë 1 Në pronësi ose me qera

3 Autobot Uji Copë 1 Në pronësi ose me qera

4 Autobetoniere Copë 1 Në pronësi ose me qera

5 Fadrome me goma Copë 1 Në pronësi ose me qera

6 Mini fadrom Copë 1 Në pronësi ose me qera

7 Eskavator me zinxhir Copë 1 Në pronësi ose me qera

8 Motobetoniere Cope 2 Në pronësi ose me qera

9 Minieskavatore Copë 1 Në pronësi ose me qera

10 Fabrike betoni e pajisur me leje mjedisore Në pronësi ose me qera ose kontrate furnizimi

11 Matrapik Cope 1 Në pronësi ose me qera

• Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërtetojnë pronësinë e mjetit: - certifikatën e pronësisë; - leja e qarkullimit; - certifikatën e kontrollit teknik; siguracionin; leja e transportit që leshohet nga njesia vendore dhe fotot perkatese; ndërsa për mjete të marra me qera krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerave e cila duhet të përshijë objektin perkates dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.

• Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatëse, ndërsa për mjete të marra me qera krahas dokumentacionit të mesipër, duhet të paraqitet edhe kontrata e qerës e cila duhet të përfshijë objektin perkatës dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.

Në ankesën e tij operatori ekonomik "Ndregjoni" shpk pretendon se bashkimi i operatoreve ekonomik "AGBES KONSTRUKSION" shpk dhe "2AF" nuk kanë dorëzuar dokumentacion të rregullt për automjetet dhe konkretisht për automjetin fadrome me goma cope 1 në pronësi ose me qera. Komisioni i shqyrtimit të ankesave nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike vëren se në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik "AGBES KONSTRUKSION" sh.p.k, ka dorëzuar SHTOJCEN 10 ku ka deklaruar mjetin fadrome me goma: - Për mjetin fadrome me goma operatori ekonomik "AGBES KONSTRUKSION" shpk ka dorëzuar vetëm faturën e çdoganimit dhe fotot e mjetit.

Komisioni i shqyrtimit të ankesës vëren se dokumentacioni i operatorit ekonomik "AGBES KONSTRUKSION" shpk për këtë mjet nuk është i rregullt pasi mjeti fadrome me goma është një mjet që është i regjistruar në regjistrin publik dhe si i tillë ky operator për të përmbushur këtë kriter duhet të paraqiste dokumentacionin sic kërkohet në dokumentat e tenderit të cilat janë: - çertifikatën e pronësive; - leja e qarkullimit; - çertifikatën e kontrollit teknik; siguracionin; leja e transportit që leshohet nga njesia vendore dhe fotot perkatëse;

Në nenin 46, pika 1 gërma "b" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.

b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;"

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit..."

Neni 26, pika 8, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose 6

c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Pretendimi i palës ankimuese se dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatoreve ekonomik “AGBES KONSTRUKSION” shpk dhe “2AF” per automjetet nuk eshte i rregullt qendron.

Referuar shpjegimeve të mësipërme mbi shqyrtimin e ankesës e kryer në përputhje të plotë me dokumentat standarte të tenderit , Ligjit 9643, date 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, Neni 46 , pika 1 , neni 53, pika 3 dhe Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 “Per rregullat e prokurimit publik”, (i ndryshuar), neni 14, Neni 26, neni 74 pika 1, 2, 3 rezulton se bashkimi i operatorëve ekonomikë “AGBES KONSTRUKSION” shpk dhe “2AF” Shpk nuk permbush kriteret e vecanta per kualifikim te përcaktuara ne dokumentat e tenderit.Sa më sipër, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës vendosi që argumentimet dhe pretendimet e paraqitura në ankesë janë mbështetur në aktet ligjore për prokurimin publik.

Ne keto kushte ankesa e paraqitur nga operatori ekonomikë “Ndrejoni” Shpk per skualifikimin e bashkimit te operatoreve ekonomik duhet te pranohet pjeserish vetem per dy nga pretendimet e ngritura kurse pretendimet e tjera jane te pabazuara ne rregullat e prokurimit publik.”

III.1.5. Në datën 27.08.2019, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke parashtruar të njëjtat pretendime përsa i përket kualifikimit të shoqërisë “Ndrejoni” sh.p.k. Për skualifikimin e tij ankimuesi shprehet se:

“Nje dite pasi kemi mare pergjigje nga AK, njoftohemi nepermjet sistemit qe oferta jone eshte refuzuar per arsye qe nuk i dime. Bazuar ne parimet baze te nje procesi te rregullt ligjor Ankimuese nuk mund te mari nje mase me te rende nese ankohet nje proces administrativ ose gjyqesore. Po keshtu per sa kohe qe AK nuk na kishte klasifikuar ne vendin e pare ne kete Procedure Prokurimi, bazuar ne LPP asnje ankimues nuk ligjerohet te ngreje pretendime ndaj ofertes tone per sa kohe qe asnje OE nuk eshte demtuar apo rrezikon te demtohet per shkak se nuk kishte asnje operator tjeter te kualifikuar pas ofertes tone. AK ka shkelur teresisht dhe ne menyre te hapur LPP duke u hakmarre per shkak te ankeses tone.

III.1.6. Rezulton se në ankesën e datës 14.08.2019 drejtuar autoritetit kontraktor BOE ankimues Agbes Construction” sh.p.k & “2AF” sh.p.k ka ngritur pretendime lidhur me vlerësimin e procedurës të datës 09.08.2019 duke kërkuar skualifikimin e operatorit ekonomik “Ndrejoni” shpk . Ndërkohë konstatohet se në datën 26.08.2019 BOE ankimues është njoftuar lidhur me arsyet e veta të skualifikimit nga procedura e prokurimit objekt ankimi. Në ankesën drejtuar KPP BOE ankimues kundërshton arsyet e veta të skualifikimit dhe njëherazi kërkon skualifikimin e operatorit ekonomik “Ndrejoni” shpk.

III.1.7.Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63, pika 1, 2, 5 dhe 6, të ligjit nr. 9643, dt.20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në të cilin është parashikuar:

1. Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.

1.1 Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa

ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni.

1.2 2. Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.

1.3 5. Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t'ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës.

1.4 6. Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor”.

III.1.8. Në nenin 20 të VKM nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik” parashikohet si vijon:

1. Ankesa drejtuar Komisionit paraqitet në gjuhën shqipe në përputhje me formularin standard të ankesës sipas modelit të aneksit nr. 2, që i bashkëlidhet kësaj rregulloreje. Komisioni publikon në faqen zyrtare formularin standard të ankesës.

2. Ankesa duhet të përmbajë domosdoshmërisht elementet e mëposhtme:

a) Të dhënat identifikuese të ankimuesit;

b) Referimin për procedurën konkrete mbi të cilën paraqitet ankimi

c) Bazën ligjore;

d) Një përshkrim të shkurtër të shkeljes së pretenduar;

e) Shkallët e ankimit shoqëruar me dokumentacionin përkatës dhe vendimin e autoritetit kontraktor, nëse ka;

f) Dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën;

g) Pretendimin e ankuesit për vendimin përfundimtar.

3. Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me:

a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni;

b) kërkesën për përjashtimin e ndonjë anëtari të Komisionit për shkak të konfliktit të interesit, nëse ankimuesi ka dijeni paraprakisht për shkakun;

c) kërkesën për ekspertizë të posaçme, kur kjo çmohet e nevojshme për zgjidhjen e çështjes.

III.1.9. Sa më sipër, KPP gjykon se pretendimet e operatorit ekonomik ankimues të ngritura pranë KPP-së lidhur me skualifikimin e ofertës së tij nuk kanë respektuar shkallët e ankimit të parashikuar nga neni 63 i LPP si më sipërcituar. KPP gjykon se BOE ankimues në momentin e marrjes dijeni lidhur me arsyet e veta të skualifikimit duhet të kishte paraqitur ankesë së pari pranë

autoritetit kontraktor në respekt të shkallëve të ankimimit. Ankimi i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke mos respektuar shkallët e ankimimit sikurse përcaktohet në ligjin e sipërcituar, sjell si pasojë që ai të mos ketë përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimimit në autoritetin kontraktor, duke mos plotësuar në këtë mënyrë njërin nga “elementet e domosdoshëm të ankesës” dhe përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik.

KPP gjykon se operatori ekonomik ankimues, në respektim të shkallëve të ankimimit, duhet të kishte ngritur këto pretendime pranë autoritetit kontraktor, ashtu sikurse është përcaktuar specifikisht në ligjin e prokurimit publik. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se nuk mund të shprehet mbi pretendime të cilat nuk janë bërë paraprakisht objekt ankese pranë autoritetit kontraktor. Objekti i ankesës së paraqitur pranë autoritetit kontraktor në respekt të shkallëve të ankimimit nuk mund të shtohet në momentin e paraqitjes në KPP.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, për shkak të ligjit (ipso lege), pretendimet e BOE ankimues lidhur me skualifikimin e tij të cilat nuk janë ngritur fillimisht pranë autoritetit kontraktor, nuk mund të merren në shqyrtim nga KPP.

III.2. Lidhur me pretendimet e BOE “Agbes Construction” sh.p.k & “2AF” sh.p.k përsa i përket kualifikimit të padrejtë të shoqërisë “Ndregjoni” sh.p.k nga ana e autoritetit kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”* i ndryshuar, *“Të drejtat e personit të interesuar”* parashikon se: *“Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.”*

III.2.1. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të paraqesë (argumentojë) se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP është i papranueshëm.

Neni 63, pika 1, kërkon shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor.

Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk ka ndonjë interes të ligjshëm për të mbrojtur.

Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk arrin të realizojë interesin e tij të ligjshëm.

Duke analizuar rastin në shqyrtim, në kontekst të këtij precedenti, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, pretendimi i BOE ankimues nuk legjitimohet pasi, interesi i tij i ligjshëm, nuk ka sesi të dëmtohet nga dështimi i operatorit ekonomik “Ndregjoni” sh.p.k sa kohë që vetë bashkimi i operatorëve ekonomikë “Agbes Construction” sh.p.k & “2AF” sh.p.k ngelet i skualifikuar në procedurën e prokurimit objekt ankimi pasi sikundër arsyetuar edhe më sipër nuk ka respektuar shkallët e ankimimit lidhur me arsyet e tij të skualifikimit.

Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real (*përkundrejt atij imagjinar*) nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Rrjedhimisht, pretendimet e BOE “Agbes Construction” sh.p.k & “2AF” shpk nuk merren në shqyrtim

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik BOE “Agbes Construction” sh.p.k & “2AF” sh.p.k., për procedurën e prokurimit me Nr.REF-23330-05-22-2019, me objekt: “*Kanali Strembec*”, me fond limit 18 915 724 lekë pa tvsh, zhvilluar ne daten 24.06.2019 nga autoriteti kontraktor Bashkia Përmet.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1436 Protokolli

Datë 27.08.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha